

FONDACIONI QENDRA EUROPIANE



- Fondacioni Qendra Europiane është një organizatë jo-fitimprurëse, e pavarur, e themeluar në qershor 1999, e cila e shtrin aktivitetin e saj në të gjithë Shqipërinë.
- Misioni i Qendrës është të kontribuojë në konsolidimin e shtetit të së drejtës, me një fokus të veçantë në standardet e të drejtave të njeriut dhe përmirësimin e njohurisë së përgjithshme mbi procesin e integritit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.
- Qendra ka në fokus implementimin e projekteve të saj jo vetëm në qytete të mëdha, por edhe në qytete të vogla dhe zona të largëta, si dhe bën të gjitha përpjekjet për të përfshirë në projektet e saj grupet e marxhinalizuara si: fëmijët, gratë, personat me aftësi të veçanta, komunitetin Rom dhe Egjiptian dhe personat me pamundësi të tjera.

Aktiviteti i Qendrës është i fokusuar në 4 programe kryesore:

- Shteti i së Drejtës;
- Integrimi Evropian;
- Të Drejtat e Njeriut;
- Demokracia dhe Qeverisja e Mirë.



Bashkëpunime në nivel ndërkombëtar

- Qendra është anëtare e *Rrjetit European të Zbatimit*, Strasburg, i cili bashkepunon me organizata të shoqërisë civile dhe aktore të tjere në mbare Europen, duke mbajtur në fokus që vendimet e GJEDNJ-se të sigurojnë mbrojtje reale të të drejtave themelore të njeriut.
- Qendra është gjithashtu partnere e '*Botës Europiane*', një rrjet me bazë në Bruksel me grupe ekspertësh nga mbi 140 shtete, Universitete dhe OJF.

Bashkëpunime në nivel kombëtar

- Qendra është pjese e Rrjetit për zbatimin e Strategjisë së Edukimit Ligjor të Publikut, së bashku me organizata të tjera të shoqërisë civile, të cilat në bashkëpunim të ngushtë me Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, punojnë në drejtim të ELP.
- Qendra ka qenë anëtare e Komisionit Ad Hoc të Shoqërisë Civile për vlerësimin e kandidaturave nga OSHC-të për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë.
- Qendra Europiane është partnere e Delegacionit të Komisionit Evropian në Tiranë, Këshillit të Evropës, Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, OSFA, USAID, Ambasadës së SHBA, Ambasadës Holandeze, Civil Rights Defenders, Fondacionit Konrad Adenauer, Këshillit Britanik, Gjykatës Kushtetuese të RSH, Gjykatës së Lartë të RSH, Gjykatës së Apelit Tiranë, Shkollës së Magjistraturës etj.



Aktivitete të Qendrës në kuadër të edukimit ligjor të publikut

➤ Në kuadër të migracionit të parregullt

- Projekti “*Integrimi drejt tregut të punës – Unë mundem!*” 2018 - 2020.

Donator: GIZ GmbH

Synimi: Informimi i të rinjve 14-18 vjeç mbi rregullat e migrimit dhe problematikat e migrimit të parregullt; Nxitja e të rinjve drejt arsimit dhe formimit profesional si një mundësi më e shpejtë për tu integruar në tregun e punës.

- Projekti “*Risqet e migrimit të parregullt*” – 2020

Donator: GIZ GmbH – Programi për Diasporën

Synimi: Informim dhe këshillim i stafit të AKPA-së në nivel lokal dhe të rinjve, në lidhje me mënyrat e rregullta të migrimit, risqet e migrimit të parregullt, mundësi punësimi sezonale, arsimit dhe formimi profesional.

E DREJTA PËR TË MOS U
DISKRIMINUAR: GARANCITË NË
DISA FUSHA TË MBROJTURA

BARAZIA GJINORE DHE
DISKRIMINIMI GJINOR

MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI
NË ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE SINJALIZIMI

GJUHA E URRJEJTJES:
JURISPRUDENCA DHE
ZHVILLIMET AKTUALE

- Në kuadër të barazisë gjinore dhe mbrojtjes nga diskriminimi:
- Projekti “Të drejtat e mia! – Përmirësimi i njohurive mbi barazinë gjinore nëpërmjet internetit” 2019-2020
- Donator: Fondi Kanadez për Nisma Lokale (CFLI)
- Synimi: Rritja e kapaciteteve të stafit të KMD dhe AP, si dhe përmirësimi i njohurive të të rinjve mbi barazinë gjinore dhe mbrojtjen nga diskriminimi.

- Platforma: tedrejtatemia.al



PLATFORMË TRAJNIMI ONLINE
Të drejtat e mia

Të drejtat kushtetuese të
grave dhe vajzave

Pjesëmarrja në proceset
demokratike të
vendimmarrjes

Punësimi i grave dhe
programe punësimi

Barazia gjinore dhe mbrojtja
nga diskriminimi

- Projekti *“Ne mundemi! – Fuqizimi i grave në jetën sociale, ekonomike dhe politike nëpërmjet inovacionit” 2020-2021*

Donator: Fondi Kanadez për Nisma Lokale (CFLI)

Synimi: Rritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i njohurive mbi tematikat, për lehtësimin e pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grave dhe vajzave në jetën sociale, ekonomike dhe politike.

Aplikacioni: **Ne Mundemi**

iOS dhe Android

Online dhe offline

EDUKIMI GJINOR

NË SISTEMIN ARSIMOR
PARAUNIVERSITAR



- Projekti “*Edukimi gjinor në sistemin arsimor parauniversitar*” 2020-2021


Donator: UNICEF Albania në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit

Synimi: Ndërgjegjësimi dhe rritja e njohurive mbi diskriminimin me bazë gjinore në sistemin arsimor parauniversitar në Shqipëri, me fokus tek psikologët, punonjësit social dhe kurrikulat mësimore.



E DREJTA PËR ARSIMIM NË SHQIPËRI – ARSIMI PARAUNIVERSITAR

ZHVILLIMI I ARSIMIT TË LARTË NË SHQIPËRI



➤ Në lidhje me të drejtat në kohë pandemie:

- Projekti “*E drejta për arsim*” – 2020

Donator: Konrad Adenauer Stiftung, Zyra për Shqipërinë

Synimi: Përmirësimi i njohurive mbi kuadrin ligjor dhe institucional, kombëtar dhe ndërkombëtar mbi të drejtën për arsim.

2 module interaktive të bashkangjitura në platformën online

tedrejtatemia.al

- Projekti “*Liria e tubimit dhe organizimit në kohë pandemie*” – 2020

Donator: Konrad Adenauer Stiftung, Programi i Shtetit të së Drejtës për Evropën Juglindore

Synimi: Përmirësimi i njohurive mbi kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar mbi lirinë e tubimit dhe organizimit, shkalla e lejueshme e cenimit të këtyre lirive në kohë pandemie.

**NDIHMË LIGJORE
FALAS**



Këshillim

➤ Në lidhje me ofrimin e ndihmës ligjore falas dhe edukimin ligjor të publikut:

○ Projekti: “*Klinika e Ligjit, Universiteti i Vlorës*” – 2018-2020

Donator: Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë

Synimi: Dhënia e ndihmës ligjore parësore dhe dytësore falas për kategoritë në nevojë në Qarkun e Vlorës, si dhe edukimi ligjor i publikut nëpërmjet sesioneve informuese në komunitetet vulnerabël dhe trajnime me student të Universitetit të Vlorës.

- 295 çështje në total;
- 269 ndihme juridike parësore;
- 26 ndihme juridike dytësore (gjyqësore).

ÇFARË ËSHTË KLINIKA E LIGJIT?

Klinika e Ligjit pranë Departamentit të Drejtësisë, Fakultetit të Shkencave Humane, të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, është pjesë e një projekti të mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë dhe zbatuar nga Fondacioni Qendra Europiane.

Nëpërmjet Klinikës së Ligjit synohet ofrimi i edukimit ligjor dhe i **ndihmës juridike falas** për qytetarët dhe komunitetet në nevojë, si dhe aftësimi në praktikë i studentëve.

Klinika përbëhet nga staf i kualifikuar, avokatë dhe juristë me përvojë në trajtimin e çështjeve administrative dhe civile.

ÇFARË SHËRBIMESH OFRON KLINIKA E LIGJIT?

Klinika e Ligjit do të ofrojë një shumëllojshmëri shërbimesh juridike, të tilla si:

- ❖ Dhënia e **informacionit** lidhur me kuadrin ligjor në fuqi;
- ❖ Dhënia e **këshillimit** për çështje administrative dhe civile;
- ❖ Dhënia e **ndihmës** në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën publike;
- ❖ **Përfaqësimi** përpara organeve administrative;
- ❖ **Përpilimi i akteve** të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën;
- ❖ Ofrimi i këshillimit, **përfaqësimit dhe mbrojtjes** përpara gjykatës në çështjet administrative dhe civile.

CILAT JANË FUSHAT KRYESORE KU DO TË OFROHET NDIHMJA JURIDIKE?

- ❖ Shpërblimi i **dëmit kontraktor dhe jashtëkontraktor** të shkaktuar nga veprimtaria administrative e organeve publike;
- ❖ Sistemi i regjistrimit të **pasurive të paluajtshme**;
- ❖ Përfitimi nga **skema e sigurimeve** shoqërore dhe shëndetësore;
- ❖ **Legalizimi** i ndërtesave informale;
- ❖ Shërbimet e ofruara nga **zyrat e punës**;
- ❖ Shërbimet e ofruara nga **zyrat e gjendjes civile**;
- ❖ Regjistrimi i **pasurive të paluajtshme** të ndërtuara përpara vitit 1991 dhe që nuk kanë dokumenta pronësie;
- ❖ Përfitimi i **ndihmës ekonomike**;
- ❖ Pagesa për personat me **aftësi të kufizuar**;
- ❖ Ndjekja e procedurës për **caktimin e kujdestarëve**;
- ❖ Përfitimi nga programet sociale të **strehimit**;
- ❖ **Mbifaturimi** për furnizimin me ujë ose energji elektrike;
- ❖ Praktikab abuzive **tregtare**;
- ❖ Përfitimi i shërbimeve nga institucionet e **shëndetit publik**;
- ❖ Mbrojtja e **mjedisit**;
- ❖ Shërbime të tjera të ofruara nga **organet publike**.



• Ofrimi i ndihmës juridike parësore

Ndihma juridike parësore është dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk kërkojnë përfaqësim në gjykatë, si më poshtë:

- dhënia e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;
- dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;
- dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;
- përfaqësimi përpara organeve administrative;
- dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.

**NDIHMË LIGJORE
FALAS**



Këshillim

Cilat janë kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike?

Ndihma juridike i ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre:

- a) viktimave të dhunës në familje;
- b) viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
- c) viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;
- ç) fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- d) fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisnin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;
- dh) personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;
- e) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;
- ë) personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;
- f) personave, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;
- g) personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisnin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitim të zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;
- gj) personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;
- h) personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim





Kush e ofron ndihmën juridike parësore?

Ndihma juridike parësore ofrohet nga:

- a) punonjësit me trajnim të posaçëm;
- b) nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara;
- c) nga klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.



Çfarë dokumentesh duhet të paraqes për të përfituar ndihmë juridike parësore nga shteti?

Për ndihmë juridike parësore ju mund të drejtoheni personalisht apo me anë të shërbimit postar, pranë qendrave, klinikave apo organizatave jofitimprurëse të autorizuara, ku juristët, nëse plotësoni kriteret e përcaktuara nga ligji, do t'ju ndihmojnë në plotësimin e:

- Formulari i kërkesës dhe vetëdeklarimit për ndihmë juridike parësore;
- Formularin e vetëdeklarimit për të ardhurat dhe pasuritë;
- Formularin e vetëdeklarimit për kategoritë e veçanta vulnerabël (nëse përfshihen në këtë kategori).
- **Formularët, duhet të shoqërohet edhe nga disa dokumenta vërtetues të llojit:**
- Çertifikatë familjare, dhe në varësitë rasti;
- Vërtetim papunësie;
- Vërtetim që trajtohet me ndihmë ekonomike;
- Vërtetim që trajtohet me kemp (paaftësi mendore/fizike);
- Vërtetim mbi pasuritë e paluajtshme që disponon;
- Vërtetim page bruto dhe neto;
- Vërtetim nga sigurimet shoqërore në rast të pagesës që kryhet prej këtyre institucioneve sikurse mund të jetë pensioni i pleqërisë.

FALEMINDERIT PËR VËMENDJEN!

Sindi Lica, Menaxhere Projektesh